



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE



DIVIZIONI TEKNIK

TERMA REFERENCE

“Përfitimi i shërbimit të evadimit të mbetjeve hidrokarbure TEC lundrues Vlorë dhe trajtimi i tyre përfundimtar”

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT..... ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

HISTORIKU I VERSIONEVE DHE NDRYSHIMEVE TË DOKUMENTITERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

1. HYRJE	3
1.1. Vlerësimi i përgjithshëm.....	4
1.2. Popullsia.....	4
1.3. Trashëgimia kulturore.....	4
1.4. Zonat e mbrojtura.....	4
1.5. Hidrologjia.....	4
1.6. Tokat bujqësore.....	6
1.7. Sistemi i transportit.....	6
1.8. Karakteristikat gjeografike dhe klimatike të zonës së Vlorës.....	6
1.9. Pozita gjeografike.....	6
1.10. Rrezatimi diellor.....	7
1.11. Temperatura e ajrit dhe reshjet atmosferike.....	7
2. PËRSHKRIMI IMPIANTIT TERMIK LUNDRUES I PËRKOHSHËM TEC VLORË....	7
3. BAZA LIGJORE.....	8
4. LLOGARITJA PËRFUNDIMTARE E SASISË SË MBETJEVE HIDROKARBURE.....	7
5. TË DHËNAT TEKNIKE TË SHËRBIMIT QË DO TË KRYHET.....	9
6. INFORMACION PËR MBETJET HIDROKARBURE TË HFO.....	9
7. DETYRAT E KONTRAKTORIT.....	10
8. SIGURIMI TEKNIK.....	11
9. MAKINERITË DHE PAJISJET E NEVOJSHME.....	11
10. TABELA PËRMBLEDHËSE E SHËRBIMEVE DHE AFATEVE.....	12
11. MBËSHTETJA QË DO TË OFROJË KESH SH.A.....	12

1. HYRJE

Këto terma reference përfshijnë kërkesat për realizimin e shërbimit të evadimit të mbetjeve hidrokarbure të projektit të gjenerimit termik “Impianti termik lundrues i përkohshëm dhe infrastruktura ndihmëse” që do të përdoret për TEC Lundrues në përdorim të shoqërisë KESH sh.a.

1.1. Vlerësim i përgjithëm për Bashkinë Vlorë

Vlora ka një pozicion të favorshëm, në kryqëzimin e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore në të gjithë rajonin. Distanca nga kryeqyteti i vendit, Tirana, është 135 km, ndërkohë që vetëm 72 km e ndajnë nga Italia dhe 77 milje nga Greqia. Qyteti i Vlorës shtrihet ndërmjet Ujit të Ftohtë dhe Zvërnecit. Rrafshi mbi të cilin ngrihet qyteti i Vlorës ka lartësi nga 6 m deri në 76 m mbi nivelin e detit dhe përfaqëson një nivel bazë kontinental. Ndërsa gjatësia e përgjithshme e vijës bregdetare është 90 km, nga grykëderdhja e Vjosës deri në Karaburun, e cila është shpallur nga Këshilli i Ministrave zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit. Qyteti i Vlorës është i ndarë në 5 njësi administrative.

1.2. Popullsia

Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 629 km². Duke marrë të dhënat e censusit, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 167 banorë/km². Dendësia e popullsisë së Bashkisë Vlorë është më lartë se dendësia e popullsisë në nivel kombëtar. Popullsia për Bashkinë Vlorë sipas të dhënave të censusit të vitit 2011 është 104,827 banorë.

1.3. Trashëgimia kulturore

Territori i bashkisë Vlorë prezanton një nga zonat më të pasura me monumente e site arkeologjike të Shqipërisë. Brenda qytetit të sotëm të Vlorës ruhen gjurmët e Aulonës antike mesjetare e cila rrethohet nga një sërë qendrash të tjera siç janë Triporti në veri, Kanina, Radhima, Tragjasi, Dukati dhe Oriku në lindje dhe jug ku janë zbuluar mbetje dhe gjurmë arkeologjike nga prehistoria deri në mesjetën e vonë. Këto qendra kanë qenë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Brenda territorit që mbulon, Bashkia e Vlorës është administruese e të gjithë vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe artistike. Midis qendrave të banuara të përmendura që bëjnë pjesë në Bashkinë e Vlorës në pikëpamje të vlerave të trashëgimisë historike e kulturore që ato mbartin mund të veçojmë qytetin antik të Aulonës, Triportit, Kaninës dhe Oriku si dhe disa qendra të tjera si Gramën e Rrëzën e Kanalit në Karaburun, Kalaja e Sofës dhe Marko Boçarit në Tragjas.

1.4. Zonat e mbrojtura

Rrënojat historike janë të shpërndara brenda dhe jashtë qendrës së qytetit të Vlorës, në fshatrat përkatëse të kësaj bashkie. Këto zona të cilat mbartin një rëndësi të veçantë për vetë rrethin e Vlorës, duke marrë parasysh të gjitha vlerat dhe historikun e tyre, janë shpallur zona të mbrojtura. Në këtë rast mund të përmendim zonat të cilat janë shpallur të mbrojtura.

1. Aulona e lashtë
2. Triport
3. Tragjas
4. Rrëza e Kanalit (Karaburun)
5. Oriku

1.5. Hidrologjia

a. Ujërat nëntokësor

Bashkia Vlorë ka një numër të madh ujërash nëntokësore më një rëndësi si natyrore ashtu edhe ekonomike. Ato përfshihen në basenin e ujërave nëntokësore kuaternare të Vjosës me një koeficient shfrytëzimi që varion nga 0.5-0.7; temperatura nga 14- 18.7°C; pHvarion nga 7.00-8.25. Ato janë burime karstike që gjenden përgjatë zonës bregdetare, dhe në brendësi të territorit të kësaj bashkie. Burimet e këtyre ujërave dalin në dy nivele; niveli i parë është ai afër zonave të banuara dhe niveli i dytë përfaqësohet nga burimet nëndetare. Burimet buzëdetare dhe nëndetare janë një lloj i veçantë i burime karstike. Në zonën e Nartë-Vjosës këto ujëra gjenden në thellësi të cekta kryesisht në thellësi nga 1m deri në 10 m. Në pjesën tjetër të Bashkisë (Xyherinë, Panaja, etj) ujërat nëntokësore gjenden edhe më thellë dhe janë burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të fshatrave, pasi uji

i rrjetit është mjaft i ndotur si pasojë e amortizimit shumëvjeçar të tij dhe si pasojë e mungesës së investimeve të rehabilitimit. Në Novoselë fortësia e këtyre ujërave rezulton Fp nga 15.01- 15.43°gj; ndërsa përmbajtja në Ca rezulton e lartë në vlera nga 52.14-97.08mg/l. Tendenca e rrjedhjes së këtyre ujërave është drejt perëndimit në detin Adriatik. Mungesa e kanalizimeve të ujërave urbane dhe e mos trajtimit të tyre paraprak përbën një rrezik të madh për cilësinë e këtyre ujërave dhe përdorimin e tyre për ujë të pijshëm. Në përgjithësi rreziku i ndotjes përcaktohet si mesatar.

b. Ujërat sipërfaqësorë

Ujrat sipërfaqësor në këtë rajon përfaqësohet kryesisht nga lumi i Vjosës, i cili derdhet në detin Adriatik, veri të lagunës së Nartës. Ndotja ka ndryshuar ekosistemin duke sjellë si pasojë më të dukshme, shfarosjen e rrapit lumor. Përveç ndotjes, përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor dhe gjuetia e paligjshme po çon drejt degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë. Nga monitorimet e raportuara në raportin mjedisor 2014 të kryera në pesë pika(stacione) të ndryshme si Mifol, Carshovë, para derdhjes në det etj, të realizuara me një shpeshiti prej më së paku tre herë në vit rezulton se NBO5 është në vlera të ulta që variojnë nga 2-3mg/l me një tendencë në rritje në vite; vlerat NKO janë të ulta nga 3.5 deri në 6.8mg/l; fosfori total me vlera nga 0.014 deri 0.029 mg/l; përmbajtja me NO2 rezulton në vlera shumë të ulta; për nga përmbajtja e NH4 ky basen rezulton i cilësisë së dytë me vlera që shkojnë nga 0.049 deri 0.123mg/l; në përgjithësi gjendja e këtij baseni konsiderohet akoma e mirë por me tendenca rritjeje të ndotjes nga Carshova në grykë-derdhje në det. Një numër masash urgjente, përveç gjositjes, duhen ndërmarrë për të parandaluar një katastrofë ekologjike. Lumi disa herë ka përmbytur zonat përreth duke shkaktuar dëme të mëdha në kompanitë e inerteve dhe në ekonomitë e vogla bujqësore. Këto masa duhet të sjellin parandalimin e hedhjes së mbeturinave, parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në luginën e lumit si dhe reduktimin e nxjerrjes së inerteve nga lugina e tij. Lumi tjetër i rëndësishëm është edhe ai Shushicës apo siç njihet ndryshe lumi i Vlorës, i cili është një tributar i lumit Vjosa.

c. Lagunat

Lagunat janë një tjetër trup ujqor i rëndësishëm i kësaj bashkie dhe përfshin lagunën e madhe të Nartës, lagunën e vogël të Limopuas si dhe lagunën e Orikumit. Të trija këto Laguna janë mjaft të rëndësishme për zonën si nga pikëpamja turistike ashtu edhe ajo biologjike. Shumëllojshmëria biologjike e këtyre lagunave si dhe funksioni i tyre për folëzim të shpendëve i japin atyre një rëndësi të veçantë dhe mbrojtja e tyre bëhet një domosdoshmëri.

d. Rezervuarët

Rezervuarët e ujit gjenden në fshatrat e Vlorës (si në Bestrovë, Zvërnecetj) kanë një rëndësi të dyfishtë për zonën. Së pari shërbejnë si i vetmi burim uji i ëmbël për faunën dhe së dyti edhe si burim uji për ujitje për tokat.

e. Deti

Kjo Bashki laget në veri nga deti Adriatik dhe në jug edhe nga ai Jon. Cilësia e ujërave, sipas raportit mjedisor 2014 në këto plazhe është monitoruar në katër pika të ndryshme duke filluar nga pylli i sodës, plazhi i hidrovorit, plazhi i vjetër, në plazhin e skelës dhe pranë ish shkollës së marinës dhe rezulton përmbajtja e NH4 është në vlera të larta, vlerat e fosforit që tregojnë presionin e ujërave urbane rezultojnë të larta në stacionin e plazhit të hidrovorit; NBO5 rezulton në dy prej stacioneve mbi vlerat e lejuara (hidrovori dhe plazhi i vjetër); në përgjithësi tendenca e ndotjes është në rritje sidomos në pyllin e sodës.

1.6. Toka bujqësore

Bazuar në hartën e kategorive të tokave në Republikën e Shqipërisë hartuar nga Instituti i Studimit të tokave, në zonën e Bashkisë Vlorë gjenden pothuajse të gjitha tipet e tyre. Brezi i tokave të kafenjta

malore shtrihet në pjesët më të ulëta të maleve, nganjëherë fillojnë nga 300m mbi nivelin e detit dhe shfaqen në lartësi deri në 1000-1300m mbi nivelin e detit, shtrihen si në brezin e shkurreve ashtu edhe të dushkut. Brezi i tokave të kafenjta pyjore, shtrihet në brezin e ahut dhe të pishës, në pjesën e mesit dhe të sipërme të luginave lumore, duke zënë lartësinë nga 700-1699m mbi nivelin e detit. Brezi i tokave kullotë malore që rrisin dhe zhvillojnë brezin bimor të kullotave alpine, zakonisht vendosen mbi 1500-1700m dhe ndodhet nën ndikimin e një klime të ftohtë dhe të ashpër malore, të brezit të ahut, karakteristikë për pllajtat malore veriore. Brezi i toka pyjore të kafenjta është një zonë me toka që përmbajnë më pak fosfor krahasuar me elementët e tjerë dhe përfaqësohet nga toka pyjore të kafenjta, të cilat janë formuar sidomos nga magma ultra-alkaline TIC e shkëmbinj sedimentarë.

1.7. Sistemi i transportit

Vlora është në një distancë 140 km nga Tirana dhe është e lidhur me rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet rrugës kombëtare Levan-Vlorë dhe tashmëbypassin e Fierit dhe në Jug me rrugën e Bregut nëpërmjet Qafës së Llogarasë. Rruga transballkanike me gjatësi 2.5 km me status rrugë primare interurbane, e lidhur së fundmi me rrugën kombëtare Levan Vlorë jep mundësi për zhvillimin e potencialeve të portit dhe ka ulur efektin e mjeteve të rënda në trafikun e rrugëve të brendshme të qytetit. Kjo rrugë është në gjendje të mirë dhe i përket klasifikimit D. Po kështu edhe rruga kombëtare pas ujit të ftohtë në Orikum dhe më pas në Llogara është në gjendje të mirë. Ndërkohë po punohet për by-passin e Vlorës që lidh autostradën Levan - Vlorë me rrugën nacionale bregdetare Vlorë-Sarandë, pjesa jugore e Vlorës. Gjithashtu po vazhdon projekti “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”. Rrjeti i rrugëve dytësore Vlora ka rreth 193 rrugë dytësore në gjendje relativisht të mirë.

1.8. Karakteristikat gjeografike dhe klimatike të zonës së Vlorës

Rrethi i Vlorës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare. Veçoria bazë e përgjithshme klimatike e kësaj zone është dimri i butë dhe i lagët dhe vera e nxehtë dhe e thatë. Veç veçorive të përgjithshme klimatike të zonës, është kryer dhe vlerësimi i detajuar i elementëve meteorologjikë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky vlerësim është bazuar në analizën e informacionit shumëvjeçar arkival të vendmatjeve meteorologjike.

1.9. Pozita gjeografike

Vlora ka një pozite gjeografike strategjike e cila lidhet me daljen e saj të menjëhershme në det në Perëndim dhe mbështetjen në vargmalet në lindje. Vlora ka një pozicion të favorshëm, në kryqëzimin e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore në të gjithë rajonin. Distanca nga kryeqyteti i vendit, Tirana, është 135 km, ndërkohë që vetëm 72 km e ndajnë nga Italia dhe 77 milje nga Greqia.

Pozicioni që ka Vlora garanton një lëvizje masive të turistëve vendas dhe të huaj. Gjiri i Vlorës dallohet për resurset e shumta natyrore, për biodiversitetin e pasur dhe korridoret ekologjike. Është ndër zonat me potencialin turistik më të lartë të vendit, gjë që lidhet me daljen direkt në det, me pasuritë e shumta natyrore, klimaterike, ujore, arkeologjike, historike, kulturore, njerëzore dhe ekonomike. Qyteti i Vlorës shtrihet ndërmjet Ujit të Ftohtë dhe Zvërnecit. Rrafshi mbi të cilin ngrihet qyteti i Vlorës ka lartësi nga 6 m deri në 76 m mbi nivelin e detit dhe përfaqëson një nivel bazë kontinental, ende aktiv. Ndërsa gjatësia e përgjithshme e vijës bregdetare është 90 km, nga grykëderdhja e Vjosës deri në Karaburun, e cila është shpallur nga Këshilli i Ministrave zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit. Aktualisht, qyteti i Vlorës vazhdon të zgjerohet në të gjitha drejtimet e veçanërisht drejt Bregut të Detit, sidomos drejt Ujit të Ftohtë dhe Jonufrës.

1.10. Rrezatimi diellor

Gjatë një viti sasia e këtij rrezatimit mesatar vjetor arrin vlerën 4.4 kWh/m²/ditë . Nga shpërndarja vjetore e rrezatimit diellor, rezulton se vlera më e lartë arrihet në korrik (7200 Wh/m²/ditë), ndërsa më e ulëta në dhjetor (1800 Wh/m²/ditë). Mesatarisht gjatë vitit, kjo zonë merr mbi 2500 orë me diell.

1.11. Temperatura e ajrit dhe reshjet atmosferike

Bashkia e Vlorës shtrihet në zonën e ultësirës bregdetare me karakteristikat e klimës Qëndrore Mesdhetare ku dimri është i butë, më një temperaturë minimale në muajin Janar 4,8 °C, ndërsa vera e nxehtë, e thatë me një temperaturë maksimale në muajt korrik dhe gusht 30 °C.

Reshjet karakterizohen nga shirat dhe rrallë herë në formën e borës. Periudha me reshje më të shumta, që bien rreth 80% të reshjeve është ajo nga muaji Tetor deri në muajin Maj të vitit pasardhës dhe rreth 20% bien në pjesën tjetër të vitit, që kryesisht është vera e thatë.

2. PËRSHKRIM IMPIANTI TERMIK LUNDRUES I PËRKOHSHËM TEC VLORË

Gjenerimi i energjisë nga impianti termik lundruës i përkohshëm TEC Vlorë dhe infrastruktura ndihmëse, një aktivitet ky i pajisur me Lejen Mjedisore PN-1673-03-2023, nr.4407 Prot, datë 03/03/2023, ndër detyrime të tjera ligjore, gjithashtu ka si detyrim trajtimin e mbetjeve të prodhuara nga ky aktivitet.

Ndër mbetjet e listuara në lejen e sipërpermendur, mbetjet e lëndëve hidrokarbure janë ato me rëndësinë më të lartë të menaxhimit dhe trajtimin, duke qenë se janë mbetjet me volumin dhe rrezikshmërinë më të lartë krahasuar me mbetjet e tjera.

Për këtë arsye, shoqërisë KESH sh.a i lind nevoja të prokurojë shërbimin për evadimin e mbetjeve të rrezikshme të llojit mbetje hidrokarbure.

3. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar;
- Ligji 111/2012, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;
- Ligj nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
- VKM nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”
- LigjNr. 118/2012 “Përtransportin e mallrave të rrezikshme”
- VKM Nr. 99 date 18.02.2005 -Katalogushqiptarimbetjeve

4. LLOGARITJA PËRFUNDIMTARE E SASISË SË MBETJEVE HIDROKARBURE

Mbetjet hidrokarbure janë si më poshtë:

- Mbetje të lëndës djegëse HFO
- Mbetje të lëndës djegëse LFO
- Mbetje të vajrave lubrifikante LO

Referuar listës së mbetjeve hidrokarbure të cituar në Lejen mjedisore PN-1673-03-2023, nr.4407 Prot, dt.03/03/2023 lëshuar KESH sh.a dhe identifikimi sipas kodit të katalogut ligjor është si më poshtë:

Nr.	Mbetja	Numri i katalogut	Vendi kryesor i gjenerimit	Trajtimi në instalim/impianit (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi ose riciklimi jashtë instalimit/impianitit
1.	Vajra hidraulike sintetike	13 01 11*	Gjeneratorët Tiger I & Tiger III	Depozitim në tankun e mbledhjeve të mbetjeve vajore Tiger I & Tiger III	Transport me autobote dhe trajtim përfundimtar
2.	Mbetje zifti të tjera dhe bitume	05 01 08*	Depozita e mbetjeve nga nafta së rëndë 90 m ³	Depozitim në tankun e mbledhjeve të mbetjeve hidrokarbure Tiger I & Tiger III	Transport me autobote dhe trajtim përfundimtar
3.	Llumra të fundit të depozitave	05 01 03*	Tanku i mbledhjeve të mbetjeve hidrokarbure Tiger I & Tiger III	Depozitim në tankun e mbledhjeve të mbetjeve hidrokarbure Tiger I & Tiger III	Transport me autobote dhe trajtim përfundimtar
4.	Llumra nga seperatorët ujë/naftë	13 05 02*	Gjeneratorët Tiger I & Tiger III	Depozitim në tankun e mbledhjeve të mbetjeve hidrokarbure Tiger I & Tiger III	Transport me autobote dhe trajtim përfundimtar
5.	Dhera dhe gurë që përmbajnë mbetje të rrezikshme	17 05 03*	Moli i ankorimit të anijeve (vetëm në raste aksidentesh)		Transport dhe trajtim përfundimtar
6.	Llumra që vijne nga trajtimi në vend i rrjedhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	05 01 09*		Depozitim në tankun e mbledhjeve të mbetjeve hidrokarbure Tiger I & Tiger III	Transport dhe trajtim përfundimtar

Shënimi * identifikon mbetjet e kategorizuara të rrezikshme sipas katalogut ligjor të mbetjeve.

Mbetjet hidrokarbure të lëndës djegëse grumbullohen në një depozitë për secilën anije. Secila anije ka një kapacitet rezervuari prej 50 m³ mbetje të lëndës djegëse dhe kapaciteti total i mbajtjes për të 2 (dy) anijet është 100 m³. Nga përllogaritjet historike të bëra prej kontraktorit Renco s.p.a, për një kapacitet ditor prodhimi të plotë prej 17 motorësh, mbetjet e lëndës djegëse përllogaritet 6 m³/ditë për secilën anije dhe 12 m³/ditë për të 2 (dy) anijet. Konsumi total i lëndës djegëse i të dy njësive gjeneruese termike me kapacitet të plotë është 540 ton për 24 orë funksionim. Nga kjo rezulton që për 1 ton lëndë djegëse i korespondon sasia prej 0.0222223 m³/ton.

Nga sa më sipër, për një prodhim të plotë përllogaritet që secila nga dy depozitat mbajtëse të mbetjeve të lëndëve djegëse të mbushet për 8 (tetë) ditë, pra nevojitet boshatisja me tanker nga operatorët e specializuar çdo 8 ditë (48 m³ secila anije).

Shënim: Prodhimi i mbetjeve të lëndës djegëse të dy anijeve është 96 m³ për 8 ditë kur 2 (dy) anijet punojnë me kapacitet të plotë.

Mbetjet e vajrave lubrifikantë të impianitit lundruar TEC Vlora, të emërtuar vajra hidraulike sintetike në tabelën e mbetjeve, janë 198.9 kg/ditë. I konvertuar me një densitet mesatar prej 870 kg/m³ për vajrat e motorave, rezulton një sasi prej 0.22 m³/ditë mbetje vajrash lubrifikantë.

Lidhur kjo me sasinë e lëndës djegëse të konsumuar i koresponon:

Mbetje mujore të vajrave lubrifikantë do të jetë $6.9 \text{ m}^3/\text{muaj}$ në rastin kur asetet gjeneruese punojnë pa ndërprerje me kapacitet të plotë. Referuar sasisë së lëndës djegëse të konsumuar, sasia e mbetjeve të vajit në funksion të lëndës djegëse të konsumuar rezulton: $0.0004074074 \text{ m}^3/\text{ton}$.

Depozita e mbetjeve të vajrave lubrifikantë është 30 m^3 për secilën anije, 60 m^2 në total për të dy anijet. Nga sa sipër, nevojitet të boshatiset secila depozitë çdo 4 muaj në rastin kur asetet punojnë pa ndërprerje me kapacitet të plotë.

5. TË DHËNAT TEKNIKE TË SHËRBIMIT QË DO TË KRYHET

Për të llogaritur nevojën për përcaktimin e sasisë së evadimit të mbetjeve hidrokarbure, bazuar në karakteristikat teknike të aseteve gjeneruese dhe karakteristikave të lëndës djegëse.

Grupi i punës ka marrë në konsideratë të dhënat teknike të shfrytëzimit të kryera nga kompania Renco s.p.a dhe nga analiza e mësipërme rezulton që sasia e mbetjeve hidrokarbure që do të prodhohet në funksion të konsumit të lëndës djegëse do të jetë: $0.0226297074 \text{ m}^3/\text{ton}$.

Shoqëria KESH sh.a do të furnizoj sasinë e lëndës djegëse prej 25,000 ton për funksionimin e aseteve gjeneruese.

Shoqëria kërkon që nëpërmjet palëve të treta të arrijë të marrë shërbimin e evadimit të mbetjeve hidrokarbure në “Impiantin termik lundruar të përkohshëm dhe infrastrukturës ndihmëse”.

Shërbimi i kërkuar mund të jepet vetëm nga operatorë të cilët disponojnë kapacitetet e nevojshme për evadimin e mbetjeve që rrjedhin nga aktiviteti i operimit të TEC Lundruar.

Ofertuesit duhet të sigurojnë dhënien e shërbimit gjatë gjithë periudhës që do të konsumohet sasia e lëndës djegëse prej 25,000 ton.

Në mënyrë përmbledhëse shërbimi i kërkuar do të përbëhet nga tërësia e elementëve të përcaktuara si më poshtë, të cilat të kryhen nga ofertuesi me qëllim evadimin e mbetjeve hidrokarbure që do të prodhohen nga konsumi i 25,000 ton lëndë djegëse.

Periudha e ofrimit të shërbimit do të jetë për një periudhë 2-vjecare ose deri në përfundimin e konsumit të sasisë së lëndës djegëse prej 25,000 ton.

Palët mes tyre do të organizojnë një sistem të njoftimit të kërkesës (rrjedhës së kërkesave për shërbim), i cili do të jetë pjesë e kontratës që do të lidhet mes palëve.

Nga ana e shoqërisë Renco s.p.a, janë llogaritur sasi të nevojshme për evadim në bazë ditore dhe javore në përputhje me kapacitetet depozituese të tankerave të pozicionuara në asetet lundruese.

Sistemi i magazinimit, depozitimit dhe ruajtjes së këtyre mbetje hidrokarbure të lëndës djegëse është i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për tërheqjen normale të tyre sipas periodicitetit dhe sasisë si më poshtë:

- ✓ Secila anije ka një kapacitet maksimal prej 50 m^3 . Për prodhim me kapacitet të plote të energjisë, secila anije depoziton $6 \text{ m}^3/\text{ditë}$ mbetje hidrokarbure. Rrjedhimisht, është e nevojshme të tërhiqet sasia maksimale e depozituar (rreth 96 m^3 mbetje hidrokarbure) çdo 8 (tetë) ditë pune kur imipanti do të punojë me kapacitet maksimal .
- ✓ Ndërsa depozita e mbetjeve të vajrave lubrifikantë është 30 m^3 për secilën anije, 60 m^2 në total për të dy anijet. Mbetje mujore të vajrave lubrifikantë do të jetë $6.9 \text{ m}^3/\text{muaj}$. Nga sa sipër, nevojitet të boshatiset secila depozitë çdo 4 muaj.

6. INFORMACION PËR MBETJET HIDROKARBURE TË HFO

Për të dhënë një informacion të përgjithshëm mbi llojin e mbetjeve hidrokarbure, më poshtë jepen Specifikimet teknike të produktit HFO sipas ISO 8217 2017 (ISO RME) që do të përdoret për operimin e aseteve termike.

Characteristic	Unit	Limit	Category ISO-F-											Test method reference	
			RMA	RMB	RMD	RME	RMG				RMK				
			10	30	80	180	180	380	500	700	380	500	700		
Kinematic viscosity at 50 °C	mm ² /s ^a	Max	10,00	30,00	80,00	180,0	180,0	380,0	500,0	700,0	380,0	500,0	700,0	SO 310 ^d	
Density at 15 °C	kg/m ³	Max	920,0	900,0	975,0	991,0	991,0				1010,0			ISO 3675 or ISO 12185; see 6.1	
CCAI	–	Max	850	860	860	860	870				870			see 6.2	
Sulfur ^b	mass %	Max					Statutory requirements							ISO 8754 or ISO 14596 or AS M D4294; see 6.3	
Flash point	°C	Min	60,0	60,0	60,0	60,0	60,0				60,0			ISO 2719; see 6.4	
Hydrogen sulfide	mg/kg	Max	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00				2,00			IP 570; see 6.5	
Acid number ^c	mg KOH/g	Max	2,5	2,5	2,5	2,5	2,5				2,5			ASTM D664; see 6.6	
Total sediment – Aged	mass %	Max	0,10	0,10	0,10	0,10	0,10				0,10			ISO 10307-2; see 6.9	
Carbon residue – Micro method	mass %	Max	2,50	10,00	14,00	15,00	18,00				20,00			ISO 10370	
Pour point (upper) ^d	winter	°C	Max	0	0	30	30	30				30			SO 3016
	summer	°C	Max	6	6	30	30	30				30			
Water	volume %	Max	0,30	0,50	0,50	0,50	0,50				0,50			SO 3733	
Ash	mass %	Max	0,040	0,070	0,070	0,070	0,100				0,150			SO 6245	
Vanadium	mg/kg	Max	50	150	150	150	350				450			IP 501, P 470 or ISO 14597; see 6.14	
Sodium	mg/kg	Max	50	100	100	50	100				100			IP 501, P 470; see 6.15	
Aluminium plus silicon	mg/kg	Max	25	40	40	50	60				80			IP 501, P 470 or ISO 10478; see 6.16	
Used lubricating oil (ULO): – Calcium and zinc; or – Calcium and phosphorus	mg/kg	–					Calcium > 30 and zinc > 15 or Calcium > 30 and phosphorus > 15					IP 501 or IP 470, IP 500; see 6.17			

^a 1 mm²/s = 1 cSt.

^b The purchaser shall define the maximum sulfur content in accordance with relevant statutory limitations. See Introduction.

^c See Annex E.

^d Purchasers should confirm that this pour point is suitable for the ship's intended area of operation.

7. DETYRAT E KONTRAKTORIT

- Kontraktori duhet të realizojë një inspektimin e zonës së shërbimit dhe përgatitjen e metodologjisë së kryerjes së këtij shërbimi.
- Kontraktori duhet të kryejë proceset e nevojshme për shkarkimin e mbetjeve hidrokarbure nga depozitat përkatëse të anijeve.
- Kontraktori duhet të kryejë proceset e matjes/peshimit në hyrje-dalje të objektit.
- Kontraktori duhet të sigurojë evadimin e mbetjeve hidrokarbure të TEC Llundres Vlorë duke përbushur të gjitha standardet në fuqi.
- Kontraktori duhet të sigurojë trajtimin përfundimtar të mbetjeve hidrokarbure të TEC Llundres Vlorë duke përbushur të gjitha standardet në fuqi.
- Kontraktori do të paraqitet për kryerjen e shërbimit të tërheqjes së mbetjeve hidrokarbure, sipas kërkesës së Autoritetit KontraktorKESH sh.a. Ky njoftim do të bëhet 3 (tre) ditë përpara paraqitjes në objekt, me qëllim marrjen e masave nga ana e Operatorit ekonomik.
- Vendndodhja e kryerjes së shërbimit është Porti i Ri (Triporti), Vlorë.
- Tërheqja e mbetjeve hidrokarbure mundësohet nga infrastruktura e impiantit termik. Për mbetjet e tjera hidrokarbure, pjesë e listës së sipërpërmendur, do të kërkohet nga ana e OE të vihen në dispozicion aksesorë dhe mekanizmat përkatës, që do të specifikohen në secilin njoftim paraprak për tërheqje të mbetjeve hidrokarbure.
- Automjetet që do të tërheqin mbetjet do të peshohen në hyrje dhe dalje të kantierit, në mënyrë që të përlllogaritet sasia e mbetjeve të evaduar.
- Dorëzimi i sasisë dhe identifikimi i llojit të mbetjeve të evaduar do të dokumentohen me proces-verbal për çdo evadim. Do të ketë një model dokumentacioni që do të përdoret për të evidentuar çdo detaj teknik dhe sasi për largimin e mbetjeve.
 - a. numrin e dokumentit të dorëzimit
 - b. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit
 - c. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit

- d. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim)
 - e. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve
 - f. përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasisë respektive
 - g. hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimet e tyre.
- Pas dorëzimit të sasisë së plotë të mbetjes në impiantin përfundimtar të trajtimit, marrësi në dorëzim, brenda 30 ditëve, i dërgon dorëzuesit një konfirmim me shkrim për marrjen e mbetjeve të rrezikshme

8. SIGURIMI TEKNIK

Proçeset e këtij shërbimi konsiderohen me shkallë të lartë rrezikshmërie. Në të tilla kushte duhet që të tregohet kujdes maksimal për sigurinë e personelit gjatë këtij shërbimi.

Kontraktori në çdo kohë duhet të kryejë proceset e këtij shërbimi në vend duke pasur parasysh sigurinë e stafit të vet si dhe të stafit tjetër të O&M që mund të jenë të pranishëm.

Kontraktori duhet në çdo kohë do të ketë pajisje për shuarjen e zjarrit përgjatë kohës së zbatimit të kontratës.

Kontraktori duhet të sigurohet se stafi i tij është i aftë për përdorimin e pajisjes së shuarjes së zjarrit. Gjithashtu zona e shërbimit duhet mbajtur pastër për shkak të rrezikut të madh të rënies së zjarrit duke pasur parasysh shkallë e lartë të djegshmërisë së mbetjeve që do të evadohen.

Kontraktori duhet të marrë masat për të identifikuar, zgjidhur dhe limituar përhapjen e lëndëve të rrezikshme. Çdo lëndë e rrezikshme duhet të largohet nga Kontraktori.

Kontraktori duhet të sigurojë pajisjet e nevojshme për sigurinë e stafit të tilla si helmata, çizme, dorashka, kuti të ndihmës së shpejtë si dhe pajisje izoluese, etj.

Është detyrë dhe përgjegjësi e kontraktorit që garantojë kushtet e nevojshme sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës për punonjësit e vetë që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Çdo aksident i mundshëm do të jetë përgjegjësi e kontraktorit.

Kontraktori duhet të marrë të gjitha masat e duhura paraprake për mbrojtjen e punëtorëve, personelit, publikut si dhe pasurive përreth objektit konform ligjeve në fuqi. Ai është përgjegjës i vetëm për respektimin e masave të sigurimit teknik.

Kontraktori duhet të sigurojë pengesa të përshtatshme, shenja me drita të kuqe "rrezik" ose "Kujdes" si dhe vrojtues në të gjitha vendet ku proceset e shërbimit mund të shkaktojnë çrregullime të lëvizjes normale të mjeteve ose që përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

Kontraktori, me shpenzimet e veta duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar ruajtjen e ambientit lokal nga ndotjet e ndryshme gjatë proceseve të shërbimit. Për këtë arsye, të gjitha makineritë dhe pajisjet që do të operojnë në terren duhet të jenë të pastra, të përshtatshme për transportin e materialeve pa shkaktuar derdhjen e tyre dhe konform rregullave dhe kushteve teknike të lëvizjes së tyre.

9. MAKINERITË/PAJISJET E NEVOJSHME

Në funksion të metodologjisë që do të përdori kontraktori për realizimin e këtij shërbimi minimalisht janë të nevojshme të përdoren këto pajisje/makineri:

- Makineri për evadimin e mbetjeve hidrokarbure
- Të ketë në pronësi ose të ketë kontratë të ligjshme bashkëpunimi me një impiant trajtimi/asgjësimi të mbetjeve hidrokarbure, të dokumentuar këto me liçencën dhe listën e plotë të mbetjeve për të cilat aktiviteti i trajtimit është i liçencuar

10. TABELA PËRMBLEDHËSE E SHËRBIMEVE DHE AFATEVE

Nr.	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA	VLERA
1.	Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve hidrokarbure	m ³	565.74	
	Shuma			
	T.V.SH			
	Totali			

***** Shënime të rëndësishme**

- Zëri 1: “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve hidrokarbure”** - nënkupton që O.E do të realizojë tërheqjen e mbetjeve hidrokarbure nga rezervuarët e 2 (dy) anijeve në TEC Llundrues Vlorë duke zbatuar të gjitha kushtet dhe standardet e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit si dhe transportin e mbetjeve hidrokarbure me automjete që garantojnë siguri gjatë transportimit deri në vendin e trajtimit të tyre dhe më pas trajtimi i tyre nga ana e Operatorit ekonomik.
- Operatori ekonomik ofertues do të ketë detyrim ligjor trajtimin përfundimtar të mbetjeve hidrokarbure brenda çmimit të zërit 1 (Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve hidrokarbure).
- Shërbimi i evadimit dhe trajtimi përfundimtar i mbetjeve hidrokarbure të TEC Llundrues Vlorë do të jetë për një periudhë 2-vjecare ose deri në përfundimin e konsumit të sasisë së lëndës djegëse prej 25,000 ton.
- Frekuenca e kryerjes së shërbimit nga kontraktori do të jetë në funksion të regjimit të prodhimit të aseteve gjeneruese. Operatori ekonomik ofertues do të njoftohet për kryerjen e shërbimit të evadimit dhe trajtimi përfundimtar të mbetjeve hidrokarbure në TEC Llundrues Vlorë minimalisht 3 (tre) ditë përpara kryerjes së këtij shërbimi.
- Sasia totale e mbetjeve hidrokarbure që do të tërhiqet nga operatori ekonomik do të jetë në funksion të regjimit të prodhimit të aseteve gjeneruese. Për sasinë e totale të lëndës djegëse prej 25,000 ton sasia maksimale e mbetjeve që mund të tërhiqen nga O.E sipas kësaj kontrate do të jetë 565.74 m³ mbetje hidrokarbure.
- Operatori ekonomik do të paguhet në zbatim të marrëveshjes kuadër vetëm për sasinë e mbetjeve hidrokarbure për të cilën do të kryejë evadimin dhe trajtimin përfundimtar.

7. MBËSHTETJA QË DO TË OFROJË KESH sh.a

Për inspektimet dhe investigimet e përshkruara në aktivitetet e parashikuara, KESH sh.a do të sigurojë të gjitha kalimet, lejet, etj, përpara mobilizimit nga Kontraktori të personelit teknik dhe pajisjeve.